

VENDIM
Nr. 320, datë 15.4.2015

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR “LEVAN-VLORË (SHTESAT)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Levan-Vlorë (shtesat)”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “arë”, “truall”, “kullotë”, “erodive” dhe “kultura bujqësore”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 11 858 232 (njëmbëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyqind e tridhjetë e dy) lekësh, nga të cilat:

a) për tokë “arë”, “truall”, “kullotë”, dhe “erodive”, me sipërfaqe 17 945m², me vlerën 9 666 850 (nëntë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë;

b) për “kultura bujqësore”, me vlerë 2 191 382 (dy milionë e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e treqind e tetëdhjetë e dy) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për pasuritë “arë”, “truall”, “kullotë”, “erodive” dhe “kultura bujqësore”, prej 11 858 232 (njëmbëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyqind e tridhjetë e dy) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës (zëri “Shpronësimet”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar).

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar ZVRPP”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimin e pronarëve, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 e 7, të këtij vendimi.

9. Brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
Autoriteti Rrugor Shqiptar
Sektori i Shpronësimeve

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
LEVAN-VLORË (shtesat)

N R	P R O N A R I			Z. Ka d	Nr. i pas uris ë.	Si p. pë rgj m²	Pas uris e Lloji i				Vler a leke /m²	Kultura bujqësore Vlera në lekë (sipas procesverb alit)	Vlera totale në lekë	Konfirmimi
	Emri	Atësi a	Mbie mri				Trual l m²	Arë m2	Ku llot ë m²	Ero dive m²				
1	B/P XHE MAL I			860 5	6/2 42	21 0	28				8300		23240 0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	B/P HO XHA			860 5	6/1 55	27 00	588				8300		48804 00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	HYS NI		BUL LA	119 1	21/ 63	20 0	200				393		78600	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	ARB EN		ALIA J	119 1	96/ 24	20 0	200				393		78600	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	THY RJA T	SAF ET	LIKA J	283 8	6/4 4	30 00		1127			281		31668 7	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
6	DER VIS H		HOX HA	287 0	15/ 2	17 00		293			281		82333	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
7	STO LI		BUL LA	119 1	96/ 25	45 0	200				393		78600	
8	RRA PI		QAR RI	268 9	7/5 5	23 38		1976			281		55525 6	Proces konfirmimi
9	VIRJ ON		HOX HA	287 0	32/ 9	90 0						47382	47382	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
10	AM ARI LDO		PET RITA J	276 5	111	43 00			278 8		197		54923 6	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
11	AM ARI LDO		PET RITA J	276 5	114	62 00			325 4		197		64103 8	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
12	AM ARI LDO		PET RITA J	276 5	116	58 00				5800	197		11426 00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
13	AM ARI LDO		PET RITA J	276 5	120	14 00				1400	197		27580 0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
14	RED I	RAI T	LLA NAJ	119 1	2	10 00 0						2144000	21440 00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
15	MA KSI M		MOL LA	860 5	6/2 64	91	91				8300		75530 0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	SHU MA						1307	3396	604 2	7200		2191382	11858 232	